



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:253681

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05629581

KF.nr.333/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me Gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ të paditësit Bechtel Enka – GP, me numër unik identifikues 810897712 dhe seli në Prishtinë, rr.” Mujo Ulqinaku 5/9, kati 4, të cilën me autorizim e përfaqëson Deloitte Kosova Shpk me seli në Prishtinë, rr. “Ukshin Hoti”, nr.120, H C3/2a, kati V, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlera e kontestit 247, 208.49 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 05.04.2024, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të paditësit A.R. dhe R.Z., dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Bechtel Enka – GP me numër unik identifikues 810897712, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr. 289/21 i datës 07.10.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 11.11.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit ATK, duke kërkuar të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi nr. 289/21 i datës 07.10.2021, ndërsa me precizimin e të njëjtës ka kërkuar të anulohet vendimi i të paditurës ashtu që blerjet e paditësit kundrejt subjektit NNP

Ballkani -PK gjatë vitit 2015 në shumën prej 776,312.43 të pranohen si shpenzime të zbritshme për qëllime të tatimit në të ardhurat e korporatave dhe njihet e drejta e kreditimit të TVSH si dhe nuk ngarkohet TVSH në shumën prej 58,076.69 që paditësi pranoi nga kompanitë e sigurimit në emër të kompensimit të dëmeve kundrejt palëve të treta, të detyrohet e paditura t'ia kthejë paditësit shumat si vijon : 126,724.90 euro në emër të njohjes së TVSH-së së zbritshme për blerjet nga NNT Ballkani PK dhe 19,008.72 euro në emër të ndëshkimeve shtesë, 77,631.24 euro në emër të tatimit shtesë të ngarkuar nga të ardhurat e korporatave (TAK) si rezultat i mos njohjes së blerjeve nga NNT Ballkani PK dhe 11,644.69 euro në emër të ndëshkimeve shtesë, 10.453.80 euro në emër të TVSH shtesë për kompensimet e pranuar nga kompanitë e sigurimeve për dëmet ndaj palëve të treta dhe 1,568.06 euro në emër të ndëshkimeve shtesë apo shumën e përgjithshme prej 247,031.41 euro të gjithat këto me interes prej 8 % nga data e marrjes së vendimit deri në pagesën përfundimtare. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka shtuar se vendimi i të paditurës është akt administrativ i paligjshëm pasi fillimisht nuk përmban elementet dhe standardet minimale të përcaktuara në procedurën e përgjithshme administrative. Më tej shton se gabimisht është zbatuar e drejta materiale përkatësisht ligji për TVSH dhe aktet për zbatimin e tij. Lidhur me blerjet e paditësit nga subjekti Ballkan BK në proces të kontrollit dhe në proces të ankesës tek e paditura, kjo e fundit nuk pati asnjë vërejtje sa i përket dokumentacionit shoqërues, por pa asnjë provë konkrete pretendon se transaksioni nuk ka ndodhur dhe gjoja se faturat janë fiktive. Madje në shkallë të parë gjatë procesit të kontrollit kjo është në nivel të dyshimit që transaksioni mund të jetë fiktiv, ndërsa në procedurë ankimore në shkallë të dytë pa shqyrtimin e asnjë prove shtesë dhe pa dhënë asnjë argument për të mbështetur pretendimin, e paditura konsideroj se transaksioni nuk ka ndodhur. Kjo qasje e të paditurës për të konsideruar si fiktive transaksionit pa dhënë as edhe një shpjegim ose arsye të vetme se cilat kanë qenë provat kanë shqyrtuar, faktet vendimtare për të mbështetur këtë qëndrim, ose cila është procedura që është ndjekur për të dëshmuar se gjoja transaksioni është fiktiv, shkel parimet më themelore të drejtësisë. Tutje ka deklaruar se në përgjigjen në padi për të mbështetur vendimin e saj ka bashkangjitur një aktgjykim dënues për pronarin e shoqërisë Ballkan i cili është dënuar për veprën penale shmangie nga tatimi. Kjo në fakt është prova kryesore për të mbështetur argumentet e paditësit në këtë çështje gjyqësore pasi megjithëse nuk ka informacione se ky aktgjykim është i plotfuqishëm ose jo, në të saktësohet të gjitha faturat, transaksionet me palët e treta me të cilat shoqëria Ballkan ka kryer veprën penale shmangie nga tatimi. Sigurisht në këtë aktgjykim nuk përmendet asnjë transaksion e asnjë faturë që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ka lidhje me paditësin, sepse po të kishte do të duhej të ndiqej penalisht edhe paditësi. E paditura i ka anuluar certifikatën e tvsh shoqërisë

Ballkan PK me dt 19.09.2020. Sipas nenit 16 të UA nr. 15/2020 për zbatim të ligjit mbi ATK-në përcaktohet se vetëm pas datës të publikimit të T/P në njërin nga listat e T/P të pasivizuar transaksionet që ndodhin pas kësaj date nuk lejohen si shpenzime të zbritshme për TAK dhe nuk lejohet kreditimi i tvsh. Transaksionet ndërmjet paditësit dhe shoqërisë së tretë ka ndodhur në vitin 2015 pra para datës së publikimit në listën e T/P të cilëve i është revokuar certifikata e tvsh, vetëm këto transaksione paditësi posedon të gjitha dëshmitë: si kontratat, faturat, specifikacionet për secilin shërbim dhe më e rëndësishmja edhe pagesa e që asnjë prej tyre nuk kundërshtohet nga e paditura. Lidhur me provën e prezantuar nga e paditura se paditësi ka vetëm një kamion, konsideron se është argument për të mbështetur ligjshmërinë e aktit administrativ, meqë i njëjti është i datës 13.09.2018, ndërsa transaksioni me paditësin ka ndodh në vitin 2015, pala ka mund të huazoj kamion ose të nën-kontraktojë shërbimet dhe jo domosdoshmërisht duhet të bëhet me kamion në pronësi të palës, faturat përfshijnë datën e blerjes, targat e mjetit transportues, pesha e bartur, koha e nisjes, vendi i ngarkimit, destinacioni, çmim dhe informatat tjera relevante. Lidhur me tatimin shtesë dhe ndëshkimet në emër të kompensimeve të pranuar në emër të kompanisë së sigurimit e paditura i referohet nenit 61 par 1.2 dhe 1.3 të UA 03/2015 për zbatimin e ligjit për TVSH-në. Neni 61 i UA është nxjerrë në zbatim në nenit 41 të ligjit për TVSh dhe duhet të kuptohet dhe të interpretohet me nenin 41 të këtij ligji i cili adreson rregullime e zbritjes për TVSh , gjegjësisht rregullon situatat se kur njohja e fillestare TVSh së zbritshme duhet të rregullohet, dhe se qëllimi i nenit 61 të UA është të detajoj procedurën se si bëhet rregullimi i zbritjeve që ekskluzivisht vie në shprehje në rastet kur T/P për mallrat që kanë blerë ose kanë importuar kanë njohur fillimisht tvsh e zbritshme. Par. 1 i nenit 61 vendos në përjashtim të përgjithshëm se kur nuk është e nevojshme të bëhet rregullimi i TVSh të zbritshme e që sipas këtij par është në situatën e mallrave të dala jashtë përdorimit për shkak se bëhen të papërdorshme ose iu ka kaluar afati. Megjithatë ekziston një përjashtim i cili është mëshiruar në par 2 të nenit 61 të një njëjtit udhëzim ku përcaktohet se nëse për këto mallra të shkatërruara ose të dëmtuara për të cilat është marrë tvsh e zbritshme në blerje T/P pranon kompensim nga kompanitë e sigurimeve atëherë në shumën e pranuar ngarkohet TVSH. Ndërsa nëse asnjëherë nuk është njohur tvsh e zbritshme për një mall ose pasuri atëherë nuk ke çfarë të rregullosh pavarësisht nëse ai mall dëmtohet ose shkatërrohet dhe për pasojë nuk zbatohet nenin 41 të ligjit për TVSh dhe neni 61 i UA, e veçanërisht në situatën ku paditësi ka vepruar si ndërmjetës në mes palëve konkretisht kompanisë së sigurimit dhe në anën tjetër palëve treta të cilëve iu ka shkaktuar dëm.

E paditura në përgjigje në padi të datës 29.06.2022 ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 03.04.2024 ka theksuar se qëndrojnë në tërësi pranë përgjigjes në padi në të cilën kanë kundërshtuar të gjitha pretendime të cilat pala paditëse i ka paraqitur me padinë e tij. Po ashtu ka kundërshtuar edhe pretendimet të cilat pala paditëse i paraqiti në seancën dhe atë duke shtuar se vendimi kontestues është vendim i cili përmbajtjen e tij e ka tërësisht të bazuar në dispozita ligjore të LKA dhe se paditësi nuk theksoj se çfarë i mungon këtij vendimi në përmbajtjen e tij të cilat parashihet në nenin 47 dhe 48 të LKA-së dhe kjo kundërshtohet në mënyrë të plotë nga ana e ATK-së. Për kontestin e parë që ka të bëjë me mosnjohjen e furnizimeve, ka argumentuar se ATK është bazuar në hetimet të cilat i ka bërë ndaj këtij subjekti si palë e tretë i cili është dëshmuar edhe me aktgjykimin me të cilin e kanë deponuar në gjykatë si tatim pagues i cili ka bërë lëshimin e faturave fiktive. Në bazë të informatave të cilat ATK i posedon e të cilat kanë të bëjnë me listën e automjeteve të cilën i ka poseduar ky T/P e të cilën si provë po e dorëzoi në seancë, ka sqaruar se shihet se në listën e këtyre aseteve e ka pasur vetëm një automjet transportues. Andaj për ATK mundësia e bartjes përkatësisht shërbimit për paditësin ka qenë e pamundur në bazë të këtyre aseteve të tij. Për pretendimet të cilat pala paditëse i theksoj lidhur me anulimin e certifikatës së TVSH gjykata duhet të ketë parasysh faktin se anulimi i këtyre dokumenteve nuk mund të bëhet në mënyrë automatike nga ATK, por anulimi i këtyre dokumenteve bëhet në momentin që ATK vëren parregullsi përkatësisht lëshim të faturave fiktive. Tutje thekson se nuk është kontestuese fakti i përmbajtjes së faturës, transaksionit bankar si dhe kontratës të lidhur në mes paditësit dhe këtij subjekti tatimor por kontestuese është fakti i transaksionit real për të cilën ATK konsideron që nuk ka mundur të bëhet një gjë e tillë. Lidhur me kontestin e dytë që ka të bëjë me trajtimin e shumave të kompensimeve të dëmeve, ka sqaruar se në bazë të gjendjes faktike ATK vlerësimin e saj mjaft mirë e ka mbështetur me dispozitën ligjore përkatësisht me nenin 61 par 1.2 të UA 03/2015. Së fundi ka shtuar se se paditësi për vlerën e njëjtë kontestuese veç ka pranuar TVSh të zbritshme andaj konsiderojnë që pretendimi i paditësit që në njërin anë të bëjë zbritje të TVSh ndërsa në anën tjetër të kërkojë që të lirohet nga kjo shumë është e pabazuar dhe është e paqëndrueshme. Andaj, gjykatës i ka kërkuar që ta refuzojë si të pabazuar padinë dhe të lë në fuqi vendimin kontestues.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 05.04.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimin nr. 289/2021 i datës 07.10.2021, Raporti i kontrollit i datës 15.07.2021, Ankesë e paditësit e datës 13.08.2021, Kërkesë për kompensim debi kredi të paditësit, Kontrata për

shërbime ndërmjet paditësit dhe NNT Ballkan të datës 20.01.2015, Fatura 02/2015 e datës 31.01.2015 e shoqëruar me specifikacionet të shërbimeve të pranuar, Dëshmia e pagesës përmes llogarisë bankare, Konfirmimi që NNT Ballkan – PK i është tërhequr certifikata e TVSh nxjerrë nga web faqja e ATK, Aktgjykim P.nr. 1324/2019 i datës 30.12.2020, Lista e automjeteve në posedim të NNT Ballkan - Pk lëshuar me datës 13.09.2019 nga SMRM.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga Raporti i Kontrollit i ATK-së i datës, gjykata ka konstatuar se e paditura ATK-ka kryer vlerësim tatimor-kontroll për paditësin, për periudhat dhe llojet e tatimeve; Tatim Mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për periudhën 07/2014-12/2015, Tatim WM për periudhën 07/2014-12/2015, Tatimin CM për periudhën 07/2014-12/2015 dhe WR për periudhën 07/2014-12/2015. Sipas të njëjtit paditësi është ngarkuar me qarkullim shtesë në shumë prej 217,686.70 €, dhe ndëshkime 32,652.83 në total 250,339.53 euro i cili qarkullim kryesisht ka rrjedh nga blerjet me subjektin Ballkan PK të cilën kontrolli nuk i ka pranuar si blerje të rregulltat për qëllime të TVSH dhe TAK, duke llogaritur TVSH shtesë në vlerën 126,724.90euro dhe ndëshkime në vlerën 19,008.73 euro dhe TAK shtesë në vlerën 77,6321.24 euro dhe ndëshkime në vlerën 19,407.81 euro, si dhe për periudhën 09/2015-12/2015 kompensim të dëmit ndaj një prone të palëve të treta në vlerë prej 58,076.69 e cila nga kontrolli është konsideruar si e hyrë e tatueshme për qëllime të TVSH e si rezultat i të cilës kontrolli ka konstatuar tatim shtesë në vlerë 10,453.80 euro dhe ndëshkime në vlerën 1,568.07 euro.

Nga vendimi i kontestuar me nr.289/2021 i datës 07.10.2021, gjykata ka konstatuar se e paditura ATK-Divizioni i Ankesave, duke vepruar sipas ankesës së tatimpaguesit, këtu paditësit, ka refuzuar ankesën e paditësit, duke konfirmuar kështu Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll sipas Raportit të Kontrollit të ATK-së të datës 15.07.2021. Në arsyetim të vendimit të kontestuar e paditura-Divizioni i Ankesave ka theksuar se lidhur me mosnjohjen e faturave me kompaninë Ballkan, ka arsyetuar se vërteton se tatimi shtesë me kontroll ka rezultuar nga parregullsitë e regjistrimeve të tatimpaguesit- gjegjësisht nga mos pranimi i faturave të blerjeve nga biznesi NNT Balkan – PK pasi tatimpaguesi ka pasur transaksione me biznese që

sipas ATK-së konsiderohen delikuate-fiktive si dhe nga mos trajtimi i drejtë i kompensimit të dëmit të pranuar nga kompania Willis LTD mes seli në Londër ashtu siç parashohin dispozitat ligjore. Më tej ka arsyetuar se nuk janë kontestuese faturat dhe kontratat që i plotësojnë kriteret sipas ligjit në aspektin formal, por kontestuese është se në realitet transaksionet në mes BEGP dhe Balkan PK nuk kanë ekzistuar, andaj me të drejtë kontrolli nuk i ka pranuar në mbështetje të neneve 14, 19 dhe 45 të Ligjit nr.03/L-222. Ndërsa lidhur me kontestin e tatimpaguesit se kontrolli ka bërë trajtim jo të drejtë të shumave të kompensimit të dëmeve të pranuar nga kompanitë e sigurimeve duke u bazuar në neni 41 të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH dhe neni 61 të UA nr.03/2015, ka konstatuar se mbetet në fuqi vlerësimi i kontrollit dhe se bazuar në këto dispozitat është dashur të deklaroj TVSH-ën për të ardhurat e pranuar në emër të kompensimit të dëmeve, me normën 18 % andaj kontrolli ka konsideruar se për këto të hyra është dashur ti deklaroj në TVSH për periudhat 09/2015 deri 12/2015. Ndër të tjera vendimi kontestues në arsyetimin e tij lidhur me pikën kontestuese të kompensimit të dëmeve ka theksuar se kur një çështje është e rregulluar me ligjet tatimore të brendshme, të njëjtat kanë prioritet ndaj ligjeve-praktikave të shteteve tjera dhe standardeve të kontabilitetit.

Nga aktgjykimi P.nr.1324/2019 i datës 30.12.2020, gjykata konstaton se pronari i kompanisë NNT Ballkan – PK është shpallur fajtor për veprën penale shmangien nga tatimi, ashtu që ka paraqitur fatura fiktive në ATK- duke blerë fatura fiktive nga kompanitë: Cani-H, Vali-SHPK, Princesha SHPK dhe Qëndrimi SHPK.

Nga konfirmimi i printuar nga webfaqja e ATK-së, gjykata konstaton se subjektit Ballkan PK certifikata e TVSH-së i është anuluar me datë 19.09.2020.

Gjykata pasi ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimeve të të paditurës, nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete. Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. E paditura në arsyetim të vendimit kontestues ka arsyetuar se vërteton se tatimi shtesë me kontroll ka rezultuar nga parregullsitë e regjistrimeve të tatimpaguesit-gjegjësisht nga mos pranimi i faturave të blerjeve nga biznesi NNT Balkan – PK pasi tatimpaguesi ka pasur transaksione me biznese që sipas ATK-së konsiderohen delikuate-fiktive, e që për gjykatën rezulton të jetë arsyetim i pa-qartë dhe kontradiktor me vet provat e paraqitura

nga e njëjta, respektivisht nga aktgjykimi i bashkangjitur nga i cili konstatohet se pronari i biznesit NNT Balkan -PK është shpallur fajtor për veprën penale shmangien nga tatimi, ashtu që ka paraqitur fatura fiktive në ATK- duke blerë fatura fiktive nga kompanitë: Cani-H, Vali-SHPK, Princesha SHPK dhe Qëndrimi SHPK, por nuk përmend edhe fatura fiktive me këtu paditësin e aq me tepër kur nga ekstrakti i nxjerr nga webfaqja e të paditurës konstatohet se tatimpaguesit NNT Balkan PK certifikata e TVSH-së i është anuluar me datë 19.09.2020, ndërsa faturat të cilat pretendohet të jenë fiktive datojnë nga viti 2015. E gjithë kjo del të jetë kontradiktore me bazën ligjore, respektivisht me nenin 16 par 6 të UA nr.15/2010 me të cilën shprehimisht është përcaktuar se “ *Pas publikimit të paraparë në paragrafët 1, 2, 3 dhe 5 të këtij neni, transaksionet me tatimpaguesit e publikuar nuk do të njihen për qëllime të kërkesës për zbritje të shpenzimeve në një deklaratë tatimore të të ardhurave apo kërkesës për kreditim të zbritshëm në një deklaratë të TVSh-së, sipas paragrafit 9 të Nenit 19 të Ligjit dhe paragrafëve 6 dhe 7 të Nenit 23 të këtij Udhëzimi Administrativ.*”

E paditura një konstatim të tillë do të duhej ta bazonte në prova dhe dëshmi konkrete dhe jo vetëm ti mjaftonte ky konstatim abstrakt dhe se arsyetimi i tillë i pa-qartë dhe kontradiktor është i barasvlershëm me mungesë të arsyetimit e që paraqet shkelje në dëm të këtu paditësit e pa evitimin e të cilës nuk mund të procedohet tutje. Prova e dorëzuar sipas të cilës ndër automjetet e tatimpaguesit NNT Balkan PK, ka vetëm një të tipit kamion dhe se pretendimi i të paditurës se me një kamion nuk mund të bartet i gjithë ai mall, për gjykatën del të jetë në kundërshtim me vet arsyetimin e vendimit kontestues, për faktin se lista e automjeteve e prezantuar gjatë seancës është e datës 2018, ndërsa shërbimet kanë ndodhur në vitin 2015, provë e cila nuk ishte konstatuar nga e paditura në vendimin e saj dhe e cila për gjykatën nuk i arsyeton të metat e vendimit kontestues.

Ndërsa, lidhur me pjesën kontestuese të trajtimit jo të drejtë të shumave të kompensimit të dëmeve të pranuar nga kompanitë e sigurimeve, e paditura është mjaftuar vetëm duke arsyetuar se bazuar në nenin 41 të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH dhe nenit 61 të UA nr.03/2015, ka konstatuar se mbetet në fuqi vlerësimi i kontrollit dhe se bazuar në këto dispozitat është dashur të deklaroj TVSH-ën për të ardhurat e pranuar në emër të kompensimit të dëmeve, me normën 18 % ,andaj kontrolli ka konsideruar se për këto të hyra është dashur ti deklaroj në TVSH për periudhat 09/2015 deri 12/2015. Ndër të tjera vendimi kontestues në arsyetimin e tij lidhur me pikën kontestuese të kompensimit të dëmeve ka theksuar se kur një çështje është e rregulluar me ligjet tatimore të brendshme, të njëjtat kanë prioritet ndaj ligjeve-praktikave të shteteve tjera dhe

standardeve të kontabilitetit, e i cili arsyetim sipas gjykatës është kontradiktor me dispozitat ligjore të ligjit 05/L-037, respektivisht nenit 118 me të cilin është përcaktuar se : “ *Aty ku ligjet ekzistuese tatimore që lidhen me tatuarjen e transaksioneve për TVSh për mallrat dhe shërbimet nuk adresojnë tatuarjen e tillë, ato mund të interpretohen me parimet e Direktivave të Sistemit të TVSh së Bashkimit Evropian dhe gjykimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.*” E paditura nuk ka arsyetuar nëse prona e siguruar është pronë e këtu paditësit apo palëve të treta, nuk ka analizuar pretendimet dhe provat e paditësit se kompensimi është bërë për palën e tretë, shuma e pranuar a i është transferuar apo jo personit të tretë, por vetëm është konstatuar se kompensimi është pranuar nga kompania Willis LTD dhe është konsideruar si e hyrë.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj Gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me çështjet e theksuara si më lartë.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 se: “*Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit*”. Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla*”.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Me nenin 43, par 2, të LKA-së, përcaktohet se: “*Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar*

rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrative”. Andaj, Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedure të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë te obligueshme për organin e paditur, edhe duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata konform nenit 43 par.2, dhe 46 par 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.333/22 datë 05.04.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.